

1 E martë, 8 mars 2022

2 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen dhe
3 Konferencë për Ecurinë e Çështjes së Viktimave]
4 [Seancë e hapur]

5 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.30

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Mirëmëngjes. Mirë se keni ardhur të gjithë.

9 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
11 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
12 Specializuar kundër Salih Mustafës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, zonja Sekretare.

15 Të prezantojmë palët tani.

16 Z. Prokuror, ju lutem, kush është i pranishëm nga Zyra e
17 Specializuar?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

19 Sot Prokuroria përfaqësohet nga Silvia D'Ascoli,

20 Ndhmësprokurore; Filippo de Minicis, një tjetër

21 Ndhmësprokuror; Julie Mann, Menaxhere e Lëndës; Agathe

22 Tregarot, stazhiere. Dhe unë quhem Cezary Michalczuk, jam

23 Prokuror.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Mbrojtësja e Viktimave.

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve. Viktimat
3 pjesëmarrëse në këtë proces përfaqësohen nga zonja Zegveld,
4 bashkëmbrojtëse dhe nga unë Anni Pues, kryembrojtëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit shumë.

7 Z. avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuara Gjykatëse.
9 Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius Von Bone, Betim Shala,
10 bashkëmbrojtësi; dhe përkthyesi dhe hetuesi z. Fatmir Pelaj;
11 me videolidhje na bashkohet dhe z. Mustafaj. Faleminderit
12 shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Po Zyra Administrative, kush është i pranishëm nga ju?
16 Keni fjalën.

17 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Jam
18 Jonas Nilsson nga Divizioni i Shërbimeve Gjyqësore.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Mustafa, a funksionon lidhja në rregull? A na dëgjoni në
21 rregull?

22 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
24 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit
25 Gjykues numër I.

1 Sot do të zhvillojmë konferencën përgatitore të Mbrojtjes
2 dhe konferencën për ecurinë e çështjes së viktimave, që
3 zhvillohet përpara paraqitjes së provave nga Paneli, nga Trupi
4 Gjykses, me kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave dhe përpara
5 hapjes së paraqitjes së provave nga Mbrojtja.

6 Përpara se të fillojmë, për publikun do të jap një
7 historik të shkurtër.

8 ZPS-ja e hapi paraqitjen e provave më 15 shtator 2021 dhe
9 i ka paraqitur provat midis periudhës 20 shtator 2021 dhe 2
10 shkurt 2022. ZPS-ja e ka mbyllur zyrtarisht paraqitjen e
11 provave më datë 4 shkurt 2022.

12 Në të njëjtën ditë, Mbrojtja ka informuar Trupin Gjykses
13 se synonte që të dorëzonte një mocion për rrëzimin e të
14 gjithave akuzave të ngritura ose të disa prej tyre që janë
15 ngritur kundër të akuzuarit, ky mocion është rrëzuar - më
16 falni - dhe nëse ky mocion do të rrëzohej atëherë do të
17 paraqiste provat e veta.

18 Më 23 shkurt 2022, Trupi Gjykses e rrëzoi mocionin e
19 Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave; F326. Më 1 mars, me udhëzim
20 nga Trupi Gjykses, Mbrojtja dhe Mbrojtësja e Viktimave kanë
21 dorëzuar parashtrimet e tyre sa i takon paraqitjes së provave
22 gojarisht dhe jo gojarisht të cilat dëshirojnë që të paraqesim
23 përpara Trupit Gjykses.

24 Më 7 mars, Trupi Gjykses ka marrë parashtrimet nga
25 Mbrojtja, me numër F335, nga Zyra Administrative, me numër

1 F337 dhe ZPS-ja, me numër F338, lidhur me paraqitjen e provave
2 nga Mbrojtja dhe paraqitjen e provave të thirrura nga Trupi
3 Gjykues me kërkesë të Mbrojtëses së Viktimave.

4 Qëllimi i kësaj konference sot është që të bëhen
5 përgatitjet për paraqitjen e provave të thirrura nga Trupi
6 Gjykues me kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave dhe për
7 paraqitjen e provave nga Mbrojtja.

8 Do të shikojmë pikat e rendit të ditës për të trajtuar
9 disa prej problemeve të ngritura.

10 Pas kësaj palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave do t'u jepet
11 mundësia që të ngrenë ndonjë problem sipas nevojës. Trupi
12 Gjykues pastaj, nesër, do të lëshojë disa urdhra gojarisht, në
13 orën 14.30.

14 Përpara se të fillojmë me pikën e parë në rendin e ditës,
15 u lutem palëve dhe pjesëmarrësve që të respektojnë rendin e
16 ditës siç është përcaktuar në vendimet tona dhe nëse është e
17 mundur të mos përsëriten ato që i kam përjashtuar me shkrim.

18 Pika e parë në rendin e ditës, që është deklarata hyrëse
19 e Mbrojtjes. Mbrojtja ka bërë të ditur se do të mbajë një
20 deklaratë hyrëse, e këtë e keni bërë të ditur me parashtrim e
21 protokolluar 333.

22 Mbrojtja, a do të jetë e gatshme që ta bëjë deklaratën
23 hyrëse ditën e martë, 22 mars 2022?

24 Diçka tjetër. Trupi Gjykues vëren parashtrimet e
25 Mbrojtjes me numër 333, 335, ku ajo bën të ditur se i duhen dy

1 orë për deklaratën hyrëse dhe se do të përdorë edhe paraqitje
2 grafike dhe instrumente të tjera. Trupi Gjykues dëshiron që
3 t'i kujtojë avokatit të Mbrojtjes se duhet të komunikojë me
4 NJAGJ-në, me ZPS-së, Mbrojtësen e Viktimave dhe Trupin Gjykues
5 këto elemente grafike, siç janë harta apo fotografi, të cilat
6 synon t'i përdorë, duke i përmendur edhe me numrin ERN, të
7 cilat këto janë të paraqitura në *Legal Workflow*. Nëse Mbrojtja
8 synon të përdorë ndonjë paraqitje grafike, e cila nuk është
9 nxjerrë përpara, atëherë këto t'i vihet në dispozicion NJAGJ-
10 së, ZPS-së, Mbrojtëses së Viktimave dhe Trupit Gjykues në
11 format elektronik, për t'u siguruar që ato do të shtohen në
12 *Legal Workflow* përpara hapjes së paraqitjes së provave nga ana
13 Mbrojtja.

14 Z. Avokat, keni fjalën.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Po përpiqem ta gjej në kalendar.

16 Data 22 mars është e martë. Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Javën
18 tjetër nuk e kemi sallën në dispozicion, pra, nuk mund ta
19 përdorim sallën e gjyqit, por javën që vjen pas javës tjetër,
20 mund ta përdornim dhe do të donim që të vijonim.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kuptoj. Unë kam parashikuar që
22 dëshmitari i parë të jetë në javën e parë të marsit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
24 avokat, thatë "mars", javën e parë të marsit. E keni fjalën
25 për prillin, besoj?

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po. Për prillin. Prandaj, do
2 të ishte më mirë për ne që ta kishim deklaratën hyrëse javën e
3 fundit të marsit, që të kishte një lloj lidhje, një lloj
4 vazhdimësie. Nuk e di a do të ishte e mundshme që të bëjmë
5 deklaratën hyrëse dhe menjëherë të vijojmë me dëshmitarin e
6 parë të Mbrojtjes.

7 Unë kam vlerësuar rreth dy orë. Dhe besoj se është një
8 vlerësim i gjatë sepse, gjithsesi, mendojmë se mund të bëhet.
9 Të themi, nëse fillojmë në 9.30 deri në orën 11.00 besojmë se
10 do ta mbarojmë. Pastaj mund të fillojmë me dëshmitarin e parë
11 të Mbrojtjes. Kjo ishte ideja që kisha unë në mendje. Por,
12 nëse ju dëshironi që ta bëjmë më herët, mund të jetë e
13 mundshme. Duhet të konsultohemi dhe me klientin tonë për të
14 parë. Sepse do të donim të kishim një lidhje disi me
15 dëshmitarin e parë të Mbrojtjes. Qoftë edhe për të mos humbur
16 kohë.

17 Kjo ishte dhe ideja që kishim. Megjithatë jemi të hapur.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i
19 takon kohës, ky është pikërisht njëri prej faktorëve që kemi
20 mbajtur parasysh. Prandaj do të ishte e dobishme që, nëse jemi
21 gati të fillonim sa më shpejt. Do të diskutojmë edhe më pas
22 fillimin e mundshëm të dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve në
23 sallë. Se mbase dhe me këtë mund të bëjmë diçka për ta sjellë
24 më përpara. Megjithatë mund ta diskutojmë më vonë.

25 Unë prej jush nuk dëgjove një "jo", por kuptoj që

1 dëshironi të konsultoheni me klientin, do t'jua jap mundësinë
2 që të konsultoheni me klientin tuaj. Por, për arsye
3 planifikimi, nëse -- probleme të vështira për të mos e bërë,
4 ne do të preferonim që të fillonim sa më shpejt. Kuptohet me
5 datat jemi në një formë orientuese tani, se për të parë se
6 çfarë apo kur mund të fillojmë. Gjatë pushimit do t'ua jap
7 mundësinë, sepse pushimin do ta bëjmë, si zakonisht, në orën
8 11.00. Atëherë, pra, do t'ua japë mundësinë që të konsultoheni
9 me klientin tuaj.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Sa u takon elementeve grafike,
11 nuk besoj se do të përdorim elemente grafike të cilat nuk janë
12 nxjerrë në paketat tona të nxjerrjes. Me shumë siguri një
13 hartë, ndonjë gjë tjetër që mund ta kemi përgatitur, këto lloj
14 gjërash. Nuk e dimë në fakt sesi funksionon paraqitja grafike
15 në ekran. Prandaj dhe unë kam dhënë vlerësimin prej dy orësh
16 për deklaratën hyrëse. Por besoj se do ta mbyllim brenda një
17 sesioni një orë e gjysmë, siç bëjmë zakonisht. Por edhe
18 njëherë e përsëris, prandaj dhe vlerësimi është shumë i
19 përfaqësues.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
21 brenda një sesioni thoni. Unë e kuptoj se dhënia e vlerësimeve
22 shumë precize nuk është gjithmonë e lehtë. Nuk është gjithmonë
23 e nevojshme që të jepen dy vlerësime të përfaqësues sepse është
24 gjithmonë e hapur arsyeja pse ju duhet më shumë kohë. Pa
25 problem domethënë.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Gjithsesi, me të gjitha
2 vlerësimet tona, ne përpiqemi që ta kufizojmë objektin e
3 gjerave që dëshirojmë të bëjmë, prandaj se edhe në këtë rast,
4 unë kam dhënë vlerësimin dy orë për të qenë brenda, për të
5 vazhduar mbase edhe pas një sesioni.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
7 në rregull.

8 Z. Prokuror, dëshironi që të ngrini ndonjë çështje lidhur
9 me këtë?

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, asgjë në
11 veçanti. Së pari, e mirëpresim gatishmërinë e Mbrojtjes për ta
12 mbajtur më shkurt fjalën hyrëse, pra, deklaratën hyrëse. Sa i
13 takon parashtrimin të Zyrës Administrative, ata do të jenë
14 gati kur të jetë gati dëshmitari i parë, atë javë pra. Sa i
15 takon Prokurorisë, pra, për ne sa më shpejtë aq më mirë.

16 Për shembull, data 24, mbase do të ishte një ditë e mirë
17 për të filluar me dëshmitarin e parë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtësja e Viktimave, dëshironi të thoni diçka?

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, veç faktit që
21 ne jemi gati për të vijuar kurdo që të jenë gati palët, s'kam
22 gjë tjetër për të thënë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
24 shumë mirë.

25 Do të kaloj tani në pikën tjetër të rendit të ditës që

1 është pika që ka të bëjë me ato i cekëm dhe për të cilat do
2 t'i diskutojmë në këtë konferencë.

3 Pra, tjetra është rendi i paraqitjes së dëshmitarëve të
4 propozuar nga Mbrojtja të përfshirë në listën e dëshmitarëve
5 që i janë dorëzuar Trupit Gjykses më datë 1 mars 2022.

6 Z. avokat i Mbrojtjes, Trupi Gjykses vëren parashtrimin
7 tuaj të datës 6 mars 2022, në të cilin ju keni bërë të ditur
8 se dëshironi të ndiqni rendin e dëshmitarëve që e kishit
9 përshkruar dhe në shtojcën 1 të parashtrimit të protokolluar
10 F333.

11 Shikoj që ju po pohoni me kokë. Po, në rregull.

12 Sa i takon kësaj, Trupi Gjykses dëshiron që të pyesë
13 Zyrën Administrative nëse do të ishte e realizueshme
14 organizimi i dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve në një mënyrë
15 të atillë që, nëse një dëshmitar mbaron me dëshminë më herët
16 nga ç'është parashikuar, dëshmitari tjetër i parashikuar të
17 mund të filloj menjëherë pas tij apo pas saj.

18 Keni fjalën, Zyra Administrative.

19 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
20 Po, e thënë shkurt, është e mundshme që dëshmitarët të
21 paraqiten në këtë mënyrë brenda mundësive. Sepse bëhet fjalë
22 edhe për planifikimin e udhëtimit të dëshmitarëve në përputhje
23 me vlerësimin e bërë prej palëve, por është e mundshme që të
24 vendosen në radhë dëshmitarët për të vijuar, pra, në vijimësi.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Z. avokat i Mbrojtjes dëshironi që të bëni ndonjë
3 parashtrim lidhur me këtë.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt, ne kemi dashur që t'i
5 grupojmë disa prej dëshmitarëve që të jenë njëri pas tjetrit.
6 Singërisht, për dëshmitarin e parë, kemi llogaritur dhe kemi
7 marrë parasysh edhe kushtet e punës të personave, prandaj dhe
8 menduam që java e parë e prillit do t'i jepte mundësinë
9 dëshmitarit.

10 Jam konsultuar me zyrën përkatëse dhe sipas përgjigjes
11 nevojiten tre javë për t'u organizuar. Po nëse mund të
12 fillojmë më herët, unë vetë nuk kam kundërshtim për sa kohë që
13 të ruajmë rendin e dëshmitarëve siç është, renditjen e tyre.

14 Gjatë kohës, siç ka ndodhur edhe në rastin e Prokurorisë,
15 mund të ndodhë edhe në rastin tonë, që të ketë persona që
16 s'janë disponibël apo të gatshëm në një moment të caktuar dhe
17 kështu që mund t'ua ndërrojmë rendin. Por, sigurisht kjo
18 mbetet për t'u parë. Por, mendoj se shumë pak raste do të kemi
19 probleme me paraqitjen e njerëzve në sallë, vetëm kur nuk jua
20 lejon puna, sepse mund të jenë të vetëpunësuar apo mund të
21 kenë gjëra të cilat do t'ju duhet të kujdesen për to, çështje
22 organizimi.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Megjithatë nevojitet një farë fleksibiliteti. Por, ju kuptoj,
25 që ju thoni që ju do bëni çmos që të organizoheni me

1 dëshmitarët.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Absolutisht po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Z. Prokuror, dëshironi të thoni gjë tjetër lidhur me
6 këtë?

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, asgjë tjetër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
9 Mbrojtësja e Viktimave?

10 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, e nderuara Gjykatëse.

11 Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
13 vënë re, pra, vërejmë parashtrimet e bëra megjithëse se këto
14 mund të shtjellohen edhe më shumë në një moment tjetër gjatë
15 kësaj konference përgatitore.

16 Tema tjetër është kërkesa për masa mbrojtëse për
17 dëshmitarët e propozuar të Mbrojtjes.

18 Z. avokat i Mbrojtjes, Trupi Gjykses vëren parashtrimin e
19 Mbrojtjes se mund të kërkojë masa mbrojtëse për një dëshmitar.
20 E keni bërë këtë kërkesë me parashtrimin e protokolluar F335.
21 Trupi Gjykses dëshiron të dijë nëse Mbrojtja do të jetë në
22 gjendje t'ia bëjë të ditur Trupit Gjykses brenda të hënës, 28
23 mars, nëse një kërkesë e tillë do të bëhet dhe për cilin
24 dëshmitar po mendohet kjo kërkesë. Për të ruajtur dhe
25 konfidencialitetin e këtij informacioni mund të përgjigjeni

1 duke e bërë të ditur pseudonimin apo numrin e dëshmitarit, siç
2 dëshironi, siç e keni përcaktuar në listën e dëshmitarëve të
3 Mbrojtjes.

4 Keni fjalën.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Në momentin e dorëzimit të
6 parashtrimit të protokolluar nuk isha plotësisht i sigurt.
7 Mendoj se vetëm në një rast. Dhe besoj se për ta përbushur
8 afatin 28, nuk do të jetë e vështirë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Z. Prokuror, dëshironi të thoni diçka lidhur me këtë?

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, asgjë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
14 Mbrojtëse e Viktimave?

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, asgjë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Dëshiron Zyra Administrative të thotë diçka lidhur me këtë?

18 Z. NILSSON: [Përkthim] Asgjë, e nderuara Gjykatëse.

19 Faleminderit.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duke
21 qenë se Mbrojtja ka bërë të ditur se nuk synon të kërkojë
22 redaktime në asnjë material tjetër, do të kaloj tani tek tema
23 tjetër, që është data e fillimit të paraqitjes së provave nga
24 Mbrojtja dhe e dyta është organizimi i dhënies së dëshmisë së
25 dëshmitarëve të Mbrojtjes nga ana e Zyrës Administrative.

1 Z. avokat i Mbrojtjes, Trupi Gjykses vëren parashtrimin
2 tuaj me të cilin bëni të ditur se Mbrojtja është e gatshme të
3 fillojë paraqitjen e provave të veta javën e parë të prillit,
4 siç na e thatë edhe sot, është parashtrimi i protokolluar
5 F335. Trupi Gjykses vëren parashtrimin e Zyrës Administrative,
6 ku bëni të ditur se paraqitja e shtatë dëshmitarëve të parë të
7 listës së dëshmitarëve të Mbrojtjes për të cilët
8 dokumentacioni është i plotë, pra, jo për dëshmitarin e parë,
9 vërej se mungonte kopja e pasaportës, e të ngjashme, mund të
10 mundësohet jo më herët se 24 marsi 2022. Ju këtë na e keni
11 bërë të ditur në parashtrimin e protokolluar F337.

12 Trupi Gjykses gjithsesi dëshiron t'i kërkojë Mbrojtjes,
13 ta pyesë Mbrojtjen më saktë, nëse do të jetë në gjendje që ta
14 thërrasë dëshmitarin e parë ditën e mërkurë, 23 mars 2022, për
15 të vijuar pastaj me javën që fillon me 28 marsin, duke mbajtur
16 parasysh faktin se Trupi Gjykses do të jetë në gjendje ta
17 përdorë sallën më 23 mars, për gjithë ditën dhe një sesion të
18 enjten, 24 mars.

19 Trupi Gjykses preferon që të dëgjojë një dëshmitar për të
20 cilin Mbrojtja vlerëson një kohë më të shkurtër për pyetjet
21 kryesore, siç është për shembull, dëshmitari numër 11 në
22 listën e dëshmitarëve të Mbrojtjes, që është dëshmitari me
23 numër 1100.

24 Lidhur me këtë Trupi Gjykses dëshiron që të pyesë Zyrën
25 Administrative nëse paraqitja e dëshmitarit të Mbrojtjes 1100,

1 mund të organizohej për ditën e mërkurë, 23 mars, duke mbajtur
2 parasysh edhe datën e sipërpërmendur, 24 mars, si dita e parë
3 në të cilën mund të mundësohej paraqitja e një dëshmitari të
4 Mbrojtjes.

5 Z. avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e kuptova mirë.

7 E keni fjalën që të filloj me dëshmitarin e parë më datë
8 23 mars? Kjo është pyetja? Nuk jam i sigurt për dëshmitarin e
9 parë sepse mendoj, që ky dëshmitar -- koha që do të caktoni
10 për këtë dëshmitar do të ishte shumë e shkurtër për të bërë
11 organizimet përkatëse. Dje, më duket, bëmë organizimin
12 përkatës për pasaportën.

13 Por që ta kalonim dëshmitarin 11 në fillim, nuk më duket
14 e preferueshme duke qenë se ky dëshmitar është i lidhur me
15 dëshmitarin 9 dhe 10. Dua të them që nuk është renditja e
16 duhur për ta nxjerrë në fillim të renditjes këtë dëshmitar,
17 sepse është shumë i lidhur me dëshminë e dëshmitarëve 9 dhe
18 10. Pra, mendoj se nuk do të ishte mirë ta bënim këtë gjë edhe
19 pse është me objekt të kufizuar siç e them. Sa i takon
20 dëshmitarëve të tjetër, dëshmitarëve 9 dhe 10, kam vlerësuar
21 pesë orë, kam llogaritur mbase gjysmë dite, jo gjithë ditën,
22 mendoj që nuk do të ishte gjë e mirë ta bënim këtë.

23 Që dëshmitari i parë të paraqitet në datë 24 apo 23 mars,
24 sa më takon mua, në rregull, nëse është e mundshme që
25 dëshmitari të vijë. Nuk kam kundërshtim për këtë. Për këtë

1 dëshmitar, vlerësimi ynë është që mund të ketë nevojë për më
2 shumë kohë, po kështu dëshmitari i dytë, për të organizuar siç
3 duhet detyrimet e tyre profesionale për të qenë në gjendje të
4 vijne të japin dëshminë këtu. Kjo është. Prandaj dhe ne kemi
5 bërë këtë vlerësim për javën e parë të prillit për të qenë të
6 sigurt që çdo gjë të jetë në harmoni.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
8 por kemi dy javë, nuk duam që t'i çojmë dëm këto dy javë.
9 "Dëm" në kuptimin që ta mbajmë sallën e gjyqit të zbrazët,
10 ndërkohë që të gjitha palët janë gati që të vazhdojmë.

11 Në një mënyrë a në një tjetër, na duhet që ta vëmë në
12 efikasitet procedurën. Plus që është në interesin e klientit
13 tuaj që të vijojmë sa më shpejt, të ecim sa më shpejt.
14 Sigurisht, aspektet logjistike dhe ato organizative janë të
15 rëndësishme. Dua të jem e qartë për këtë, nuk dua që t'ju
16 ndërhyjmë në organizimin logjistik dhe të paraqitjes së
17 provave nga ana juaj, por duhet të organizohemi.

18 Por, nëse i bëj një përmbledhje përgjigjes tuaj, ju thoni
19 që dëshmitari 1100 për ju është problematike që të dëshmojë i
20 pari edhe pse është i kufizuar në dëshmi e vet, gjithsesi, ai
21 e ka të lidhur dhënien e dëshmisë me dy dëshmitarë të tjerë,
22 që janë dëshmitari 9 dhe 10.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse mund t'ju ndërpres?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Patjetër.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase mund të konsultohemi ne, si
2 Mbrojtje, për të parë se cilin dëshmitar mund të vendosim të
3 parin, nëse mund ta përfundojmë brenda datës 23 mars. Se puna
4 është, me sa shikoj, që të përdoret data 23 mars për një
5 dëshmitar. Nëse do të ishte kështu, atëherë do të preferonim
6 që të kishim, që të kërkonim një dëshmitar tjetër dhe jo këtë
7 dëshmitar.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
9 unë e kisha parashikuar këtë në përmbledhjen time, më dolët
10 përpara.

11 Po më bëhet qejfi, shikoj që jeni në të njëjtën linjë.
12 Kemi një tjetër propozim, për shembull, që mund të jetë -- që
13 do të ishte dëshmitari i cili ka dëshmuar tashmë dëshmitari i
14 Mbrojtjes me numër 1900. Ky dëshmitar është paraqitur para
15 Trupit Gjykses në shkurt 2022. Pra, Trupit Gjykses, Mbrojtësja
16 e Viktimave, palët kanë qenë në gjendje që të përgatiten dhe
17 për dëshminë e këtij dëshmitari. Në mënyrë alternative, nëse
18 ju do të propozoni ndonjë dëshmitar tjetër i cili do të ishte
19 i gatshëm të dëshmonte më datën 23 mars.

20 Sigurisht, kjo është renditja që kisha parasysh. Për
21 shkak edhe të numrit të kufizuar të orëve që keni propozuar
22 ju, na duhet gjithsesi të shikojmë edhe nevojën sesa orë ju
23 duhen sipas vlerësimit tuaj.

24 Por, nëse ju keni një dëshmitar tjetër, i cili mund të
25 paraqitet më datë 23, me një mundësi shtesë për një sesion në

1 datë 24. Por, përpara se të bëjmë këtë, ndërkohë që ju e
2 mendoni këtë, z. avokat i Mbrojtjes, do të pyes Zyrën
3 Administrative për të parë se cilat janë mundësitë sepse
4 propozimi i Trupit Gjykues nënkupton që ta sjellim një ditë
5 përpara paraqitjen e dëshmitarit të parë, pra, jo në datë 24
6 por në datë 23, nëse do të ishte e mundshme. Pra, nëse do të
7 ishte i gatshëm dëshmitari që të jepte dëshmi në Gjykatë.

8 Po, Zyra Administrative, keni fjalën, sa u takon
9 mundësive për të filluar më datë 23.

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
11 Gjykatëse.

12 Sa i takon numrit 11 në listë, kam bërë disa konsultime
13 të shpejta dhe duket që është e mundshme për ta bërë një ditë
14 më herët me këtë dëshmitar, pra, më datë 23. Po kjo për
15 dëshmitarin numër 11.

16 Dëshmitari i parë i listës, ju vetë e përmendët që ka një
17 problem me kopjen e pasaportës, kështu që është e vështirë për
18 të dhënë angazhimin për këtë gjë pa u zgjidhur ajo më përpara.

19 Sa i takon dëshmitarit të tretë që u cek këtu sot, që
20 është dëshmitari 19, ka ende, pra, mbetet ende për t'u bërë
21 kërkesa për vizën. Kështu që unë kam frikë se më e hershmja
22 kur ky dëshmitar mund të paraqitet është java që fillon në
23 datë 28 mars.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
25 Faleminderit.

1 Kam një pyetje lidhur me këtë çështje. Pyetje për Zyrën
2 Administrative.

3 Ky dëshmitar ka ardhur dhe ka dhënë dëshmi këtu në sallën
4 e gjyqit në shkurt, kështu që, me sa di unë, [REDAKTUAR]
5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
8 Gjykatëse.

9 Me sa kuptoj unë, [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR] Kështu që kam përshtypjen se duhet të aplikojmë
11 sërish [REDAKTUAR] në këtë rast.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
13 përgjigja juaj është që nuk është e mundur të kemi dëshmitarin
14 për shkak të vizës. Domethënë viza nuk është nuk është e
15 disponueshme deri më datë 23?

16 Z. NILSSON: [Përkthim] Për dëshmitarin numër 19 në listë,
17 me aq sa di unë, me sa kam konsultuar me kolegët, nuk mund të
18 sillet më përpara sesa data 28 mars.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa i
20 takon fillimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit të dytë në
21 listë, Trupi Gjygues vëren se kemi shtatë dëshmitarë, jo në
22 mënyrë të njëpasnjëshme, por shtatë dëshmitarë të cilët do të
23 ishin në gjendje që të jepnin dëshmi, të paktën nga pikëpamja
24 e vizës më datën 24. Këta dëshmitarë a do të jenë të gatshëm
25 për të qenë të pranishëm këtu në datë 23?

1 Z. NILSSON: [Përkthim] Ajo çfarë di unë specifikisht ka
2 të bëjë me dëshmitarin me numër 11. Megjithatë do të
3 interesohej dhe do t'ju them në qoftë se ka dëshmitarë të
4 tjerë të cilët mund të jenë në atë datë këtu.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
6 mendoj që ky informacioni do ishte i dobishëm për Mbrojtjen.
7 Do ishte mirë që Mbrojtja të dinte në qoftë se njëri prej
8 këtyre dëshmitarëve të përmendur në parashtrimet e Zyrës
9 Administrative, në parashtrime të cilat janë depozituar dje,
10 pra, në qoftë se ndonjëri prej tyre do të ishte i gatshëm në
11 datë 23. Sepse në varësi të kësaj mund të bëni vlerësimin tuaj
12 nëse njëri prej tyre do të ishte i mundur që të vinte dhe të
13 jepte dëshmi. Në qoftë se keni ndonjë person tjetër, ju lutem,
14 propozojeni sepse Zyra Administrative mund të shohë, mund të
15 hetojë se cilat janë mundësitë për të sjellë këtë dëshmitar.
16 Por me sa kuptoj unë, shtatë dëshmitarët që janë pjesë e
17 listës së Zyrës Administrative, që do të jenë për të ardhur
18 këtu më datë 24, ka të ngjarë të vijjnë këtu domethënë një ditë
19 më përpara më datë 23.

20 Shikoj që doni të merrni fjalën, i nderuar avokat.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë sa i takon shtatë
22 dëshmitarëve të parë, është njëri prej dëshmitarëve me të
23 cilin mund të vijojmë.

24 Atëherë e kam fjalën, në fakt, për dëshmitarët nga 1 deri
25 tek 8.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Numri
2 një, siç u informuam, ka një problem me pasaportën, nuk ka
3 kopje të pasaportës.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] E kemi, e kemi sot. Domethënë na
5 është sjellë dje dhe e kemi sot.

6 Kjo është e sigurt.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
8 atëherë.

9 Zyra Administrative, fjala për ju.

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Edhe në qoftë se e kemi marrë
11 kopjen e pasaportës sot, mund të mos jetë e mundur që
12 dëshmitari i parë të jetë i pranishëm këtu deri më datë 28
13 mars. Megjithatë, sapo mora konfirmim tani, se për të tërë
14 shtatë dëshmitarët është e mundur që të lëvizin me një ditë më
15 përpara më datë 23, në qoftë se këtë gjë e dëshiron Trupi
16 Gjykes. Kështu që për dëshmitarin numër 2, 3, 4, 6, 7, 10 dhe
17 11 - pra, të gjithë shtatë dëshmitarët që ne kemi thënë që
18 mund të jenë gati më 24 mars mund të jenë gati edhe një ditë
19 më përpara, pra, më datë 23 mars.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
21 faleminderit.

22 Avokat Mbrojtës, pyetja apo kërkesa ime për juve,
23 aktualisht, është kjo: pra, ideja kryesore është që neve duam
24 që të fillojmë më datë 23 dhe duam që të kemi një dëshmitar të
25 pranishëm për këtë datë. Unë propozoj që gjatë pushimit ju të

1 bëni një konsultim me kolegët tuaj lidhur me këtë çështje dhe
2 pastaj kur të mblidhemi pas pushimit të na thoni dhe të
3 diskutojmë pak më tepër lidhur me këtë pikë. Shpresoj që të
4 keni një përgjigje pas pushimit lidhur me këtë temë.

5 E vlerësojmë shumë gatishmërinë tuaj, vullnetin tuaj për
6 t'u përpjekur për ta organizuar sa më mirë këtë çështje.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] A mund t'ju bëj një pyetje, e
8 nderuara Gjykatëse?

9 Atëherë le të themi, le të mendojmë, që do të fillojmë më
10 datë 23 mars me deklaratën hapëse dhe do të vijojmë ditën
11 tjetër me dëshmitarin e parë. Dëshmitari i parë do të ishte
12 dëshmitari i dytë i renditur në listë; apo jo?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo,
14 sigurisht, që do të varet nga ju.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Sepse ne kemi planifikuar për 23
16 dhe 24.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
18 paradite. Ne po kërkojmë një dëshmitar i cili nuk do të marrë
19 shumë kohë, sepse në të kundërtën do të thotë që nuk do të
20 mbarojmë dot me dëshmitarin më datë 23. Sepse më datë 24
21 pasdite ka një seancë tjetër të planifikuar. Këtë mund ta
22 shikoni edhe në kalendarin publik të DHSK-së. Dhe për të
23 premtën, unë e di që salla e gjyqit nuk është e disponueshme.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, po flasim vetëm për 23
25 marsin paradite.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
2 flasim për 24 marsin paradite.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Më lejoni të konsultohem dhe
4 pastaj do t'ju jap një përgjigje lidhur me këtë temë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Pra, është bërë shkëmbim i vogël ndërmjet Zyrës
8 Administrative dhe avokatit mbrojtës. Pra, shikoj z. Prokuror.
9 Nuk e di në qoftë se doni të bëni të thoni ndonjë gjë lidhur
10 me këtë pikë?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk do e përgatisim ne, në
12 fakt, mbrojtjen e Mbrojtjes. Por, në qoftë se ne do të
13 fillonim më datë 23, do ta vlerësonim shumë, pavarësisht se
14 cili do të ishte dëshmitari i thirrur nga Mbrojtja.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Shikoj që avokati i viktimave po pohon me kokë.

17 Thjesht doja t'ju jepja të gjithëve mundësinë që të
18 shpreheshit.

19 Mirë atëherë, do të kalojmë tek java tjetër dhe ne do të
20 donim që t'ju pyesim juve, avokati i Mbrojtjes. Po,
21 gjithashtu edhe Zyrës Administrative, megjithatë, e kuptuam
22 nga konstatimet e bëra nga Zyra Administrative që dëshmia e
23 dëshmitarëve mund të planifikohet për javën e 28 marsit.
24 Kështu që pyetja që kam për juve avokat është në qoftë se pas
25 pushimit të kafes mund të vini për propozim lidhur me dy

1 dëshmitarë që do të thirren gjatë kësaj jave.

2 Shoh Zyrën Administrative. Nuk e di në qoftë se ju doni
3 të bëni ndonjë koment lidhur me këtë çështje?

4 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo. Faleminderit, e nderuara
5 Gjykatëse.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
7 atëherë. Në javën e datës 28 a ka ndonjë koment që dëshiron të
8 bëjë Prokuroria?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo. Faleminderit, e nderuara
10 Gjykatëse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 nga Avokatja e Viktimave?

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
15 është e qartë që ju jeni të gatshëm që të fillojmë kurdo që të
16 jetë e mundur.

17 Avokat mbrojtës, pra, gjatë pushimit do ju jap ca kohë
18 shtesë, pra, nuk do të bëjmë thjesht pushimin normal, po do të
19 bëjmë një pushim pak më të gjatë në mënyrë të tillë që ju të
20 organizoheni me ekipin dhe me klientin tuaj.

21 Tema tjetër në programin e ditës së sotme janë materialet
22 pezull që Mbrojtja synon që t'i nxjerrë për Prokurorinë dhe
23 për Mbrojtjen e Viktimave.

24 Trupi Gjykses vlerëson dhe tregon që ju mund të tregoni
25 disa materiale fotografike, deklarata të tilla në një fazë të

1 më vonshme të procesit. Dhe duam që t'ju kujtojmë se në pajtim
2 me rregullin 104(5) të Rregullores duhet që ZPS-së, Mbrojtëses
3 së Viktimave t'ju jepen dëshmi, dokumente dhe fotografitë
4 sipas afatit të përcaktuar nga Trupi Gjykses dhe jo më vonë.

5 Duket sikur e kemi humbur lidhjen me z. Mustafa, kështu
6 që do të presim.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Sa për informacionin tim, e
8 nderuara Gjykatëse, neve do të mblidhemi në seancë të martave,
9 të mërkurave dhe të enjteve gjatë këtyre javëve?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
11 të qenë e sinqertë, nuk kemi përcaktuar asgjë akoma. Po
12 thjesht, ne duam të vlerësojmë se çfarë mundësisish kemi. Kemi
13 mbledhur ndërkohë shumë informacion të cilin do ta
14 konsiderojmë, do ta shqyrtojmë për vlerësimet dhe gjykimin
15 tonë. Por, ne po shohim javën e 21 dhe javën e 28 marsit.

16 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës
17 këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
19 të na duhen disa minuta ndërkohë do të përditësojmë sa më
20 shpejt të jetë e mundur dhe do ta vlerësojmë në qoftë se do të
21 bëjmë një pushim tani apo në qoftë se do të vazhdojmë më tej.

22 Do t'ju kërkoj më vonë të na thoni në qoftë se do të jetë
23 e mundur që të kemi një ose dy dëshmitarë, domethënë të kemi
24 dy dëshmitarë, që presin të japin dëshminë e tyre. Do ta
25 përsëris sërish pyetjen në momentin kur të jetë i pranishëm

1 dhe i akuzuari, por thjeshtë sa për informimin tuaj, po jua
2 them paraprakisht.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Seancës
4 këshillohen]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sapo
6 më thanë, që seanca do të ndërpritet për 15 minuta, do vijojmë
7 sërish në orën 10.30.

8 --- Pauza fillon në orën 10.14

9 --- Seanca rifillon në orën 10.30

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Avokat Mbrojtës shikoj që jeni në këmbë, por gjithashtu mbaj
12 mend që ju bëra një gjysmë pyetje sa i takon materialeve që
13 Mbrojtja synon që të nxjerrë.

14 Mund të vazhdojmë me këtë pikë në qoftë se ju nuk mendoni
15 se pika që duhet të ngrini është shumë urgjente. Në qoftë se
16 nuk mendoni që është e domosdoshme që të merrni fjalën tani,
17 mendoj që mund të vazhdojmë me këtë pyetje. Mund ta trajtojmë
18 pak më vonë atë çështje që donit të ngritit?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Atëherë lidhja është në rregull z. Mustafa. Shikoj që jeni i
22 pranishëm dhe shpresoj që lidhja të jetë pa probleme deri në
23 fund. Gjithsesi do ta mbajmë situatën nën kontroll.

24 Tani le të shohim pak. Z. Mustafa nuk e di a e dëgjuat që
25 unë trajtova çështje që kishte të bënte me materialet që

1 Mbrojtja synon që të nxjerrë për Mbrojtjen e Viktimave dhe
2 ZPS-së dhe për të komunikuar me Trupin Gjykses. A e dëgjua
3 këtë pjesë apo jo?

4 Mirë atëherë do filloj nga fillimi lidhur me këtë pikë.
5 Tema tjetër janë materialet e mbetura që Mbrojtja synon që të
6 nxjerrë për ZPS-në dhe për Mbrojtjen e Viktimave. Dhe Paneli
7 vëren që parashtrret e Mbrojtjes janë të tilla që mund të
8 nxirren materialet fotografike, deklarata ose prova
9 dokumentare në një fazë më të vonët të procesit. Dhe duam që
10 t'ju kujtomë që në pajtim me rregullin 104(5) të Rregullores,
11 Mbrojtja duhet t'i nxjerrë ZPS-së dhe Mbrojtjes së Viktimave
12 deklaratat, dokumentet dhe fotografitë që synoni që të
13 përdorni si prova materiale në Gjykatë brenda afatit kohor që
14 përcaktohet nga Trupi Gjykses dhe jo më vonë se 15 ditë
15 përpara hapjes së çështjes së Mbrojtjes.

16 Që është goxha shpejt.

17 Trupi Gjykses vëren më tej, parashtrim e protokolluar të
18 ZPS-së me numër F338, që thotë që përmbledhja sipas rregullit
19 95 për dëshmitarin 500 nuk është njoftuar në pajtim me
20 rregullin 104(1) dhe nuk është përfshirë në njoftimin e
21 Mbrojtjes për alibi dhe është nxjerrë vetëm me datë 3 mars
22 2022 dhe kjo deklaratë ndërkohë është marrë në mars 2021.

23 Avokat, a dëshironi që të na jepni ndonjë koment lidhur
24 me këtë pikë të ngritur nga ZPS-ja?

25 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, ne e kemi

1 sërish këtë dëshmitar dhe pavarësisht që ky dëshmitar ka
2 dëshmuar diçka rreth vendndodhjes së Salih Mustafës, çështja
3 kryesore është që ky person është një anëtar i LDK-së. Pra ka
4 qenë anëtar i një prej degëve të LDK-së. Kështu që pozicioni
5 më i mirë, pozita më e mirë për të, për të dëshmuar për
6 çështje në qoftë se ka pasur ndonjë armiqësi në LDK lidhur me
7 përkatësinë politike ose ndonjë gjë tjetër, për këtë arsye do
8 të dëshmojë ai. Dhe në fakt ai e ka takuar z. Mustafa në disa
9 raste.

10 Dhe për këtë arsye nxjerrja e këtij dëshmitari, nuk është
11 dhënë më përpara dhe kjo është arsyeja pse deklarata e tij
12 është përfshirë në grupin e dytë.

13 Shpresojmë që deklarata e tij është e rëndësishme për
14 përcaktimin e ecurisë së të gjithë çështjes dhe vendimit në
15 fund.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit i nderuar avokat.

18 Tani Prokuroria nuk e di në qoftë se ju doni të ngrini
19 ndonjë çështje lidhur me këtë pikë.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, ne
21 pozicionin tonë e kemi dhënë në parashtrimin që kemi bërë për
22 këtë temë. Pra, ky është një dëshmitar do të duhej të ishte
23 njoftuar sipas njoftimit për alibi. Mbase mund të ketë edhe
24 arsye të tjera se pse njoftimi është bërë kaq vonë dhe avokati
25 mbrojtës mund ta shtjellojë më tej këtë çështje. Megjithatë

1 për momentin kjo është e gjitha që mund të them.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokatja e Viktimave doni të bëni ndonjë konstatim lidhur me
4 këtë çështje?

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo asgjë tjetër s'kam për të shtuar
6 veç asaj që u tha nga Prokurori.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
8 personat e pranishëm në sallë dhe vë re që për ZPS-në janë të
9 pranishëm të njëjtë persona që ishin në mëngjes.

10 Shoh që edhe për Mbrojtjen e Viktimave janë të njëjtët
11 persona.

12 Dhe për Zyrën Administrative.

13 Ndërkohë që për Mbrojtjen shikoj që kemi një person që
14 nuk është i pranishëm.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të vijë pas disa çastesh
16 mendoj, sepse ka shkuar për të marrë disa dokument. Z. Fatmir
17 Pelaj nuk është këtu i pranishëm, por do të vijë pas pak.

18 Nuk e di në qoftë se mund t'i kthehem çështjes së
19 organizimit të planit të seancave.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
21 mund të vijoni.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, çështja në
23 fakt ka të bëjë me datën 23-24 mars. Dëshmitari i parë që do
24 të jetë në gjendje që të jetë i pranishëm është dëshmitari 2
25 në listën tonë. Është dëshmitari me numrin 200. Singërisht

1 mendoj që do të ishte e dobishme që të përdoren këto dy ditë
2 për të, që të përfundojmë me dëshminë e tij dhe pastaj javën
3 që vjen të mund të bëjmë planifikimin e dëshmitarëve të tjerë.
4 Dhe ky është një dëshmitar të cilin e kemi dëgjuar edhe si
5 dëshmitar të Prokurorisë por mendojmë që do të kemi nevojë për
6 të dyja ditët për të. Kështu që në qoftë se do të thërrasim
7 një person tjetër dhe në qoftë se do të mundohemi të
8 planifikojmë vetëm paraditen, seancat e paradites për këtë
9 dëshmitar nuk do të mjaftojnë. Kështu që mendoj që do të ishte
10 më mirë që të përdornim të plotë ditën, të dyja ditët, pra për
11 dëshmitarin 200.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju po
13 flisni për 23 marsin tani apo jo?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Për 23 marsin dhe paraditen e
15 datës 24 mars.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 qoftë se është e mundur, po. E mbajta shënim këtë. Kjo do të
18 ishte një mënyrë për të vijuar.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe mendoj që do të ishte mirë që
20 ne të përfundojmë siç duhet marrjen në pyetje me këtë
21 dëshmitar specifik, konkret, se sa të mundohemi që të
22 fragmentarizojmë kohën në dispozicion të tij dhe të një
23 dëshmitari tjetër.

24 Kështu që propozimi im është ky që të kemi këtë dëshmitar
25 javën e parë dhe ndërkohë që javën tjetër që është java e

1 datës 28 mars dhe pyetja që kam për ju e nderuar Gjykatëse

2 është: Sa ditë në javë do të kemi seancë?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

4 na duhet që të vendosim për këtë. Por për ne, për Trupin

5 Gjykues do të ishte mirë që të na jepnit dy emra dhe më pas

6 duhet të shqyrtojmë pak më tej se si do të procedojmë më tej.

7 Pra, momentalisht nuk mund të jap më tepër hollësi, nuk mund

8 të jem më e qartë se sa kaq sepse jemi në momentin e mbledhjes

9 së informacionit, nuk është se kemi marrë ende një vendim.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë neve mendojmë që me datë

11 23 dhe 24 të thërrasim dëshmitarin 200 që është dëshmitari

12 numër 2 në listë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

14 kërkoj ndjesë që ju ndërpres avokat por jam informuar se

15 dëshmitari i parë, pra dëshmitari 1 në listën tuaj mund të

16 dëgjohet në javën e datës 28, në mënyrë të tillë që dokumentet

17 të jenë gati për të.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, këtë gjë doja të thoja dhe

19 unë, sepse u konsultuam gjatë pushimit me Zyrën

20 Administrative. Dhe ajo çfarë është më e rëndësishme e nderuar

21 Gjykatëse, në të njëjtën javë mbase ka mundësi që të vijojmë

22 më tej me dëshmitarin 3 në listë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 atëherë dëshmitari 1, 2, 3.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, dhe pastaj nuk ngatërrohem

1 me data ose urdhra, por jemi në një lloj rendi kronologjik,
2 pra ndjekim kronologjinë e dëshmitarëve të cilët janë dhënë në
3 listë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Kaq kisha.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 atëherë, e diskutuam këtë çështje. Nuk e di në qoftë se ka
9 ndonjë konstatim, ndonjë koment për t'u bërë nga palët.

10 Prokuroria?

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo nuk kemi asnjë koment.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Avokatja e Viktimave?

14 ZNJ. PUES: [Përkthim] Thjesht sa për qartësim. Sa i takon
15 kohës prej 7 orës, kur planifikojmë 7 orë, domethënë nuk
16 planifikohen orët për ZPS-në dhe koha që i duhet në
17 dispozicion Avokates së Viktimave. Pra thjesht sa për të qenë
18 e qartë lidhur me kohën që do të na duhet që të shpenzojmë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
20 është një tjetër gjë që do të duhet që të diskutohet, nuk mund
21 t'ju japim përgjigje lidhur me këtë pyetje.

22 Kemi marrë një kërkesë për një kohë të përafërt të
23 vlerësuar për dëshmitarët nga Mbrojtja dhe do të shohim se si
24 do t'i qasemi kësaj çështjeje.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra
2 Administrative, keni ndonjë koment lidhur me këtë pikë
3 specifike?

4 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit e nderuar Gjykatëse.
5 Thjesht sa për të konfirmuar që programi, plani që sapo
6 na u bë i ditur nga Mbrojtja mund të përmbushet nga Zyra
7 Administrative.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
9 bëra një pyetje por pastaj humbëm lidhjen me z. Mustafa. Do ta
10 përsëris edhe një herë pyetje e bërë më parë. A mundet Zyra
11 Administrative të akomodojë një ose dy dëshmitarë. Ju në fakt
12 konfirmuat për njërin, por pyetja është në qoftë se akomodoni
13 dot dy dëshmitarë, në mënyrë të tillë që të kemi gjithmonë një
14 dëshmitar gati për dëshminë e radhës në qoftë se do të jetë e
15 nevojshme.

16 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit e nderuar Gjykatëse.

17 Po, nga pikëpamja logjistike nga Zyra Administrative
18 është e mundur kjo gjë. Ne gjithmonë përpigemi që të kufizojmë
19 kohën që ju duhet dëshmitarëve që të qëndrojnë në Hagë.
20 Megjithatë nëse dëshmitë janë të shkurta absolutisht ka kuptim
21 dhe kemi mundësi ta bëjmë një gjë të tillë, që të kemi një
22 dëshmitar rezervë në qoftë se përfundohet marrja në pyetje e
23 dëshmitarit të parë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 faleminderit.

1 Atëherë avokat ne kemi diskutuar datën 23 dhe 24 paradite
2 deri tani. A mund të na konfirmoni ju lutem që me datën 22
3 juve mund të jeni i pranishëm për deklaratat hapëse.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po mundem ta bëj këtë gjë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Atëherë, pika tjetër që do të doja të diskutonim është
8 tregimi nga Mbrojtja në qoftë se dëshmitari 100, që është
9 dëshmitari i parë, do të japë dëshmi si dëshmitar ekspert. Pra
10 e kam fjalën posaçërisht për shtojcën 1 të parashtrim të
11 protokolluar F333.

12 Trupi Gjykes vëren se parashtrimi i ZPS-së për
13 dëshmitarin 100 është identifikuar si dëshmitar ekspert pa
14 njoftimin e nevojshëm të natyrës së dëshmisë së dëshmitarit
15 dhe pa ndjekur procedurën e parashikuar në rregullin 149 të
16 Rregullores.

17 Avokat mbrojtës, a dëshironi të thoni ndonjë gjë lidhur
18 me parashtrim e ZPS-së lidhur me këtë pikë.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse ky
20 dëshmitar është një person që ka qenë në Shtabin e
21 Përgjithshëm të UÇK-së. Pra, përveç kësaj, kjo është
22 ekspertiza e tij e përgjithshme. Nuk ka ndonjë ekspertizë
23 tjetër. Nuk kemi ndër mend ta përdorim si dëshmitar ekspert,
24 në kuptimin se është ekspert për një çështje të caktuar
25 materiale. Megjithatë, ai ka ekspertizë për sa i përket asaj

1 se ai ka qenë anëtar i komandës së përgjithshme të UÇK-së dhe
2 mund të tregojë dhe mund të dëshmojë për linjat e urdhërimit
3 dhe hierarkinë. Për këtë do ta përdorim.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ai
5 është dëshmitar dhe ju keni shtuar fjalën "ekspert" për të
6 përcaktuar se sipas jush ai ka njohuri për disa çështje të
7 caktuara. Por nuk keni ndjekur atë qasjen zyrtare dhe formale
8 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne nuk kemi ndonjë vëzhgim për
10 të bërë në lidhje me këtë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 Mbrojtësja e Viktimave?

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Ne nuk kemi gjë për të shtuar në
14 lidhje me këtë pikë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Paneli vëren parashtrimin e bërë nga Mbrojtja e Viktimave, që
17 janë parashtrimet e protokolluara 297 dhe 334 kur i kërkon
18 Panelit që të caktojë një ekspert forenzik-mjekësor për të
19 paraqitur pikëpamjet e tij në lidhje me një dëshmitar,
20 dëshmitarin 0505.

21 Paneli do të dijë së pari nëse dëshmitari 0505 do të jetë
22 i gatshëm të paraqitet para Panelit të hënën, më 21 mars 2020
23 në qoftë se autorizohet. Dhe në lidhje me këtë Paneli vëren se
24 ardhja e këtij dëshmitari mund të lehtësohet me një 21 mars
25 2022, jo më herët se ajo datë.

1 E dyta, Mbrojtësja e Viktimave, ju keni bërë fjalimin
2 tuaj hapës me 15 shtator dhe ky ka qeni parashtimi 283.

3 Pyetja e Panelit: A i përfshin ky parashtim ato
4 shqetësimet dhe pikëpamjet e dëshmitarit 0505 apo dëshiron
5 Mbrojtja e Viktimave të bëjë parashtim me gojë, para apo mbas
6 paraqitjes së këtyre pikëpamjeve nga ky dëshmitar?

7 Në lidhje me këtë duhet të theksojmë se personi nuk duhet
8 të theksojë ato që ka thënë në deklaratën që i ka dhënë ZPS-
9 së, që tashmë është pranuar si provë materiale sipas rregullës
10 150 të Rregullores të Procedurës dhe të Provave. Por duhet të
11 përqendrohet ky dëshmitar vetëm tek shqetësimet që ka
12 kapërcejnë atë që është thënë në atë deklaratë apo në atë
13 dëshmi.

14 Dhe së treti, Paneli dëshiron të pyesi Mbrojtësen e
15 Viktimave nëse dëshiron të kërkojë caktimin e një eksperti,
16 përveç ekspertit që ka kërkuar për t'i ndihmuar Panelit për të
17 vendosur se çfarë kompensimi do t'i jepet viktimave për atë që
18 kanë, -- dëmin që kanë pësuar.

19 Pra në qoftë se Paneli do të japi vendim fajësie dhe do
20 të vendosi për kompensim, për t'ju dhënë viktimave, a dëshiron
21 Mbrojtësja e Viktimave që të caktohet një ekspert në lidhje me
22 kompensimin financiar dhe si mendon Mbrojtësja e Viktimave që
23 të trajtojë këtë çështje?

24 Keni fjalën Mbrojtësja e Viktimave.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Për sa i përket pikëpamjeve dhe

1 shqetësimeve që do të paraqesë dëshmitari 0505 ne do të jemi
2 shumë të kujdesshëm në qoftë se do të autorizohemi që të mos
3 përsëriten deklaratat e bëra më përpara, por të ketë vetëm
4 gjëra që janë shtesë, në lidhje me dëshmitë që janë dhënë deri
5 tani.

6 Në qoftë se bëhen vëzhgime të tjera të tjera nga ana ime,
7 këto do të jenë shumë të shkurtra në mënyrë që në përgjithësi
8 -- dhe kjo do të varet edhe nga një takim tjetër që do të
9 bëhet. Pra këto parashtrime nuk do të jenë më të gjata se sa
10 një mëngjes, ndoshta një orë e gjysmë, dy orë, siç kemi thënë
11 edhe në fillim. Pra do të jetë një prezantim, një parashtrim i
12 shkurtër në kombinim me vëzhgimet e viktimës.

13 Për sa i përket caktimit të ekspertit, a mund ta diskutoj
14 pak me kolegen time dhe bashkëmbrojtësen? A është në rregull
15 kjo?

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Propozoj që të përdorni pushimin për këtë. Në qoftë se mund të
18 flisni me kolegen tuaj tani, mund ta bëni këtë, por ndoshta
19 është më mirë që t'i kushtoni vëmendje se çfarë po ndodh këtu
20 në sallën e Gjykatë se sa të diskutoni. Pra nuk do t'ju
21 shtyjmë, nuk do t'ju ngusim për dhënin e përgjigjes në lidhje
22 me këtë.

23 Faleminderit për këtë.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam diçka për të thënë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 lidhje me këtë, apo më mirë të them një herë këtë dhe pastaj
2 juve të ngrini çështjen që doni të ngrini?

3 Z. Von Bone, doni të shtoni diçka në lidhje me atë që tha
4 Mbrojtësja e Viktimave, keni ndonjë vëzhgim?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë për të thënë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka
7 Prokuroria ndonjë vërejtje në lidhje me këtë?

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Do të presim në lidhje me
9 qëndrimin që ka Mbrojtësja e Viktimave në lidhje me çështjen e
10 dytë.

11 Për sa i përket viktimës 0505, dëshmitarit 0505 nuk kemi
12 vëzhgime të mëtejshme.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra
14 Administrative ka diçka për të thënë?

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo asgjë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
17 Von Bone, ju pashë që u ngritët në këmbë. Keni fjalën.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Vetëm në lidhje me pikën e parë
19 që diskutuam për materialet që kanë mbetur ende pa u dorëzuar,
20 pa u nxjerrë, ne nuk shohim ndonjë gjë që do të jetë problem.
21 Ndonjë herë del diçka e papritur dhe në qoftë se del do t'ia
22 paraqesim Gjykatës sipas rregullave, por nuk parashikojmë të
23 na dali gjë e papritur.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Fatmir Pelaj ka hyrë, ka ardhur në sallën e Gjyqit, është i

1 pranishëm tani. Madje ka 10 minuta që ka ardhur por duam të
2 shënohet në procesverbal që ai është i pranishëm në sallë dhe
3 që ka 10 minuta që ka ardhur.

4 Ka edhe një temë tjetër dua ta diskutoj në lidhje me
5 listën e provave materiale dhe me sistemin elektronik *Legal*
6 *Workflow*.

7 Avokat Mbrojtës, ne kemi parë në listën e provave
8 materiale është 333/KOR/A02 që ka disa parregullsi dhe duhet
9 t'i trajtojmë këto probleme sepse saktësia në dhënien e
10 numrave ERN duhet të jetë plotësisht e saktë.

11 Këtë e ka vënë në dukje edhe Prokuroria në parashtimet e
12 saja. Në këtë listë disa nga provat materiale numri i
13 regjistrimit të provës ERN, nuk korrespondon me ERN që është
14 vënë si vulë, në vetë provën materiale. Për shembull, prova
15 materiale 18 në listë është me numrin ERN DSM-00198 deri
16 000198 por mban vulën ERN DSM00199.

17 Ka edhe prova të tjera të cilat janë të paraqitura në
18 mënyrë të rregullt në listë por në *Legal Workflow* në sistemin
19 elektronik e kanë gabim numrin. për shembull ky është rasti me
20 deklaratën e dëshmitarit 500 që ka numrin ERN DSM-00570 deri
21 00578, por në sistemin *Legal Workflow* ka numrat ERN 00579-
22 00579.

23 Së dyti, dhe si pasojë e kësaj disa prova të ndryshme
24 janë regjistruar në *Legal Workflow* me të njëjtin ERN. Për
25 shembull ERN DSM 00561-00561, sepse është e njëjta faqe,

1 identifikon në sistemin elektronik si deklaratën e dëshmitarit
2 200 është shtuar edhe një kopje të kartës së tij të
3 identitetit. Këto duhet të kenë numra të ndryshëm.

4 Së treti, e njëjta provë materiale është nxjerrë dy herë
5 ose me të njëjtin numër ERN ose me dy numra të ndryshëm ERN-
6 je. Për shembull e njëjta hartë është nxjerrë edhe si me
7 numrin DSM 00421 edhe si DSM 00447. Dhe kjo vlen edhe për disa
8 anekse të ndryshme të deklaratave të dëshmitarëve të cilat
9 janë paraqitur edhe si pjesë e deklaratave të dëshmitarëve
10 edhe si anekse më vete, si në rastin e dëshmitarit 1400.

11 Po kështu nuk është burimi, nuk është dhënë burimi i disa
12 prej këtyre provave në *Legal Workflow*.

13 Këto nuk janë raste të izoluara dhe shumë nga provat e
14 listës së provave, materialit të Mbrojtjes e kanë këtë
15 problem. Paneli dëshiron të shprehë shqetësimin në lidhje me
16 këtë dhe duam të dimë se pse janë këto probleme nëse Mbrojtja
17 ka pasur ndonjë vështirësi dhe çfarë ka ndodhur. Sepse duhet
18 të kemi një sistem që funksionon, që të jetë sa më perfekt që
19 të jetë e mundur. Sepse në qoftë se do të kemi numra të
20 ndryshëm ERN do të komplikohet shumë puna, në qoftë se numrat
21 nuk janë të saktë. Në qoftë se nuk ka skedim të mirë të
22 librave në bibliotekë, atëherë biblioteka nuk funksionon.

23 Pra, duam ta zgjidhim këtë problem dhe duam të dimë nga
24 ju çfarë keni thënë në lidhje me këtë.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Së pari, e nderuar Gjykatëse,

1 janë bërë dy nxjerrje gjithsej për të siguruar që Mbrojtësja e
2 Viktimave t'i merrte të gjitha materialet që duheshin.

3 Me sa di unë dhe z. Pelaj, ne kemi bërë disa korrigjime
4 në materialet apo në parashtrimet e protokolluara. Unë nuk e
5 di, ai do të më thotë se cilat janë ato.

6 Sidoqoftë, do të bëhen korrigjime sigurisht. Do ta
7 kalojmë të gjithë listën dhe do të shikojmë nëse dokumentet,
8 për shembull, një dokument që është vulosur me një numër të
9 caktuar ERN, të ketë të njëjtin numër edhe në listë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
11 kështu edhe kjo është shumë e rëndësishme dhe faleminderit që
12 do ta bëni këtë. Por është e rëndësishme që çdo provë e
13 nxjerrë të ketë vetëm një numër unik ERN-je. Sepse ju keni për
14 shembull një deklaratë me shtojca që ja keni treguar
15 dëshmitarit dhe pastaj kemi një tufë tjetër dokumentesh të
16 cilat janë nxjerrë dhe këto prova janë aty me numër tjetër
17 ERN-je.

18 Pra shtojca që i është bashkëngjitur një deklaratë ka një
19 numër ERN-je atje dhe pastaj ka një numër ERN-je në një tufë
20 tjetër dokumentesh. Kjo shkakton konfuzion.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Sigurisht ne duam të kemi një
22 numër unik të vetëm ERN-je. Me sa më kujtohet ne këto i kemi
23 nxjerrë në prill, vjet dhe në atë kohë të gjitha shtojcat e
24 deklaratave ishin të përfshira brenda në ato deklarata që
25 menduam se do të ishte më e lehtë për t'i lexuar kushdo që do

1 t'i merrte këto dokumente. Përveç kësaj, këto dokumente kanë
2 marrë edhe një numër më vete të ERN-së. Prandaj ekzistojnë dy
3 numra ERN-je.

4 Unë duhet të konsultohem me z. Pelaj në lidhje me këtë.
5 Por, cilat do të ishte preferenca? Sepse ose mund të vëmë dy
6 numra ERN-je, për shembull, për një fotografi të caktuar, një
7 si dokument më vete dhe një si shtojcë e një deklaratë, që i
8 është bashkëngjitur një deklaratë apo të ketë ato vetëm një
9 numër ERN-je. Nuk jam më i sigurt se cilat do të jetë mënyra
10 më e lehtë për at zgjidhur këtë.

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR] është si Wikipedia në lidhje me këtë çështje.

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
15 propozoi atë që do të konfirmoja - dy gjëra. Ju mund të
16 diskutoni me Njësinë për Administrimin e Gjykatës në lidhje me
17 këtë çështje. Por unë do të thoja dhe m'u konfirmua kjo, pasi
18 një dokument ka marrë një numër ERN-je të caktuar, këtë numër
19 ERN-je nuk e ndryshojmë më. Sepse për ndryshe ngatërrohen
20 gjërat.

21 Por gjithashtu është e rëndësishme ajo që sapo na thatë
22 ju që jeni i gatshëm ta kaloni edhe një herë të gjithë listën
23 e provave materiale dhe të konfirmoni që të kenë të njëjtin
24 numër, si aty në listën e provave materiale ashtu edhe në
25 sistemin *Legal Workflow*.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se do të bëhen
2 korrigjime, atëherë ne do të dorëzojmë një versin të dytë ose
3 të tretë të korrigjuar të listës së prova materiale.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Sigurisht që do të japim një urdhër për këtë, por faleminderit
6 që e shprehët gatishmërinë për ta bërë këtë, sepse na duhet të
7 kemi një listë përfundimtare e cila do të jetë pikë referimi
8 për të gjitha palët edhe për Panelin kur t'i referohemi atyre
9 provave materiale të Mbrojtjes.

10 Në rregull.

11 Atëherë burimi, origjina e disa nga dokumenteve mungon
12 edhe ajo duhet shtuar.

13 Z. Prokuror doni të ngrini diçka në lidhje me këtë
14 çështje?

15 D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, asgjë më tepër. Ne i kemi
16 mbajtur shënim këto çështje dhe kemi kontaktuar Mbrojtjen dhe
17 kemi diskutuar sidomos për çështjen e burimit të këtyre
18 dokumenteve që është shumë e rëndësishme për ne.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Mbrojtësja e Viktimave, keni diçka për të thënë në lidhje me
21 këtë?

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, asgjë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull. Ora është 11.05. do të bëjmë pushim për gjysmë ore
25 deri në 11.35 dhe do të vijmë përsëri në atë orë.

1 Faleminderit.

2 --- Pauza fillon në orën 11.06

3 --- Seanca rifillon në orën 11.36

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Atëherë shoh që palët kanë të njëjtat përbërje si edhe para
6 pushimit, nuk ka ndryshuar asgjë. Të gjithë tundin kokën në
7 shenjë pohimi. Pra përgjigja është "po".

8 Në rregull. Do të kaloj tek çështja e masave mbrojtëse
9 për viktimën që do të paraqesë pikëpamjet dhe shqetësimet e
10 veta. Përpara se ta bëj këtë, Mbrojtëse e Viktimave a e
11 konfirmuar se viktimë mund t'i paraqesë pikëpamjet dhe
12 shqetësimet e veta me 21 mars, sepse nuk e dëgjova përgjigjen
13 nëse e keni dhënë.

14 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po. Kërkoj ndjesë sepse më doli nga
15 mendja.

16 Për sa kohë që Zyra Administrative, siç e ka konfirmuar
17 në parashtrimin e vet, është e gatshme që t'i bëjë lehtësimin
18 e ardhjes viktimës, atëherë në rregull, unë e konfirmoj këtë.

19 Në qoftë se dëshironi mund t'i përgjigjem edhe pyetjes
20 edhe në lidhje me ekspertin, por mund ta lemë edhe për më
21 vonë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
23 po flasim për masat mbrojtëse dhe mund të na paraqisni
24 mendimin tuaj për këtë dhe pastaj për çështjen tjetër.

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Atëherë sa për ta mbyllur atë që

1 fillova të them para pushimit, ndoshta u shpreha pak në mënyrë
2 konfuze, sa për të qenë e qartë, se ne nuk kërkojmë dy
3 shqyrtime apo ekzaminime nga ekspertë.

4 Ekzaminimi i propozuar lidhet qartësisht me çështjen e
5 kompensimit dhe në përgjithësi me zhdëmtimet dhe kjo është
6 kërkesa jonë primare mbi bazën e rregullës 168. Dhe ky ekspert
7 duhet të caktohet nga Paneli, por vetëm nëse Trupi Gjykses e
8 mendon këtë të nevojshme për të mbështetur funksionin e vet
9 për gjetjen e të vërtetës, sepse kjo nuk është diçka që mund
10 ta vendosim ne plotësisht.

11 Ne mendojmë që Prokuroria e ka paraqitur çështjen e vet
12 dhe provat e veta në mënyrë shumë solide dhe nuk ka nevojë për
13 një ekzaminim nga eksperti për të vërtetuar kredibilitetin e
14 dëshmitarit.

15 Por në qoftë se Trupi Gjykses i cili do të vendosi në
16 lidhje me këtë çështje, në përpjekjet e tij për të gjetur të
17 vërtetën, do ta mendoni mbas diskutimeve tuaja se është e
18 nevojshme që një ekzaminim i tillë është i dobishëm për ju,
19 atëherë "po". Dhe kjo do të jetë një do të jetë një çështje e
20 vendosjes se kur do të bëhet kjo gjatë procedurës. Kjo mund të
21 bëhet pak më herët se sa faza e përcaktimit të zhdëmtimeve,
22 siç parashikohet në rregullën 132 si dhe në rregullën 127, në
23 fund të paraqitjes së provave nga Mbrojtja. Por kjo do të
24 bëhet mbasi ju të bëni vlerësimin tuaj paraprak, sepse ne po
25 përpiqemi të kemi një qasje që të jetë sa e më e ndjeshme që

1 të jetë e mundur, për sa i përket ritraumatizimit apo
2 inkriminimit, sepse çdo marrje në pyetje i shkakton stres të
3 shtuar dëshmitarëve. Pra duhet të kemi një qasje graduale.

4 Shpresoj që e kam bërë të qartë tani.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit Mbrojtësja e Viktimave.

7 Mendoj që ka një keqkuptim të vogël dhe do të përpiqem ta
8 sqaroj. Ajo që na shpjeguat ju ne tani është e qartë për ne.
9 Pra, ju keni bërë dy parashtrime të protokolluara dhe ne e
10 kishim shumë të qartë se çfarë po kërkonit ju. Dhe qëllimi si i
11 zhdëmtimit dhe i komponentit të gjetjes së të vërtetës, ju e
12 keni paraqitur. Domethënë sipas pikëpamjes tuaj, ajo që është
13 prezantuar, ajo që është paraqitur deri tani, provat që janë
14 dhënë deri tani, janë të mjaftueshme. Kështu e kuptova unë dhe
15 këtë po e shpreh me fjalët e mia. Kjo është njëra anë.

16 Pyetja që bën Paneli është një pyetje tjetër shtesë që
17 "Nëse ekipi i Mbrojtjes së Viktimave po mendon të caktohet një
18 ekspert tjetër, përveç këtij eksperti mjekësor, ekspertit
19 mjeko-ligjor, i cili do ta ndihmojë Panelin në rast se, për
20 shembull, nëse do të ketë vendim fajësie për të marrë vendim
21 në lidhje me kompensimin e viktimave?". Kjo është një çështje
22 që ka të bëjë shumë më tepër me shifra.

23 Dhe desha ta paraqes këtë çështje para jush në këto
24 momente. Nuk ka nevojë që t'i përgjigjeni kësaj tani, sepse e
25 kuptoj se me siguri duhet të mendoheni për këtë më tej dhe në

1 qoftë se nuk ka ekspert, nëse do të kërkoni të procedoni në
2 një mënyrë tjetër. Se nuk po i paraqesim ne provat apo
3 çështjen tuaj, pozicionin tuaj këtu, por për ne është e
4 rëndësishme që duam të dimë se çfarë do të na vijë në të
5 ardhmen, siç e bëjmë gjithmonë. Duam të dimë se çfarë do të
6 vijë në faza të tjera.

7 Këtë desha ta sqaroj.

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit për këtë sqarim. E
9 shënuam, e mbajtëm shënim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull atëherë.

12 Ka Mbrojtja ndonjë vërejtje në lidhje me këtë?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull.

16 Në lidhje me masat mbrojtëse Paneli kujton se viktima
17 0505 ka marrë anonimitet sipas rregullës 80(4)(a)(i) të
18 Rregullores dhe emri dhe informacioni identifikues i tij nuk
19 do t'i jepet palëve dhe publikut.

20 Mbrojtësja e Viktimave keni diçka për të thënë lidhur me
21 këtë?

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Duke pasur parasysh se janë
23 vendosur tashmë masat mbrojtëse, mendojmë që ato përfshijnë
24 masat që janë të nevojshme, kështu që mendojmë që kjo është e
25 mjaftueshme. Unë do të pyes specialistët e Zyrës së Mbrojtjes

1 dhe Mbështetjes së Dëshmitarëve. Por me ato masa mbrojtëse
2 mendoj se nuk është problem që të paraqitet viktima këtu në
3 Gjykatë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Dëshironi të thoni diçka z. Prokuror?

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. Për çështjen e mëparshme
7 nuk më dhatë fjalën për t'u shprehur dhe nuk desha të ngrihem.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
9 jua dhashë fjalën sepse folëm për kompensimin. Por nëse
10 dëshironi mund të flisni tani.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Siç tha Mbrojtja e Viktimave ne
12 jemi dakord se ne, çështja jonë dhe provat tona janë solide
13 dhe nuk kemi nevojë për dëshmi mbështetëse apo për një ekspert
14 mjekësor që ta plotësojë atë.

15 Në lidhje me zhdëmtimet në qoftë se do të duhet një
16 ekspert për ta bërë këtë, atëherë Prokuroria do të bëjë
17 parashtrimet e veta lidhur me këtë çështje më vonë. Ndoshta
18 mbasi të ketë mbaruar paraqitja e provave nga Mbrojtja.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ne do
20 ta trajtojmë këtë çështje jo tani por më vonë. Faleminderit
21 për vërejtjet tuaja.

22 Shumë mirë

23 A keni diçka për të thënë sa u takon masave mbrojtëse?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokat mbrojtës shikoj që thoni "jo".

2 Atëherë kemi pikën 10. Parashtrimet nëse do të vijë puna
3 te dhënia e dënimit të të akuzuarit. Tema tjetër, pra, është
4 kjo. Më konkretisht nëse i akuzuari konstatohet fajtohet, pra
5 shpallet fajtor. Tema që ngrihet është nëse dhënia e dënimit
6 do të bëhet me aktgjykimin apo në përputhje me rregullat 162
7 deri 164.

8 Z. Prokuror keni diçka për të thënë për këtë.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo i kemi bërë të ditur përmes
10 parashtrimeve me shkrim.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Thjesht desha të sigurohem. Në rregull.

13 Mbrojtësja e Viktimave?

14 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë, e nderuar
15 Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull, avokati i Mbrojtjes?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
20 rregull. Kjo ishte pika e fundit në rendin e ditës që kishte
21 parashikuar Trupi Gjykses për sot.

22 Nuk e di nëse palët apo Mbrojtësja e Viktimave kanë për
23 të ngritur ndonjë problem tjetër. Me Prokurorin po e filloj.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Mbrojtësja e Viktimave?

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo asgjë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Avokati i Mbrojtjes?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse do të
7 konfirmojmë edhe një herë me NJAGJ-në për sa i takon listës së
8 gjërave. Desha vetëm të bëj një sqarim, pse ndonjë herë kemi
9 dublim.

10 Ideja është kjo. Kemi një deklaratë me disa lidhje,
11 bashkëlidhje. Ndonjëherë përdorim disa lidhje me një dëshmitar
12 ose me dëshmitar tjetër. Mund të jetë fotografi, mund të jetë
13 një hartë e cila është bërë paraprakisht. Pastaj më pas mund
14 të kemi bërë harta të tjera pasi kemi bërë matjet. Të gjitha
15 këto materiale menduam se do të ishte e dobishme që t'i
16 paraqisnim veçmas, sepse mund t'i përdorte ndonjë palë,
17 fotografi apo harta të tilla. Kjo mendoj unë është arsyeja
18 përse ndonjëherë kemi dublim. Edhe pse është i njëjti
19 dokument.

20 Ta zëmë, fjala bie, është një fotografi ajrore, të themi,
21 të cilën mund t'ia kemi treguar dëshmitarit A. Mbase të
22 njëjtën fotografi mund t'ia kemi treguar edhe dëshmitarit B, e
23 kështu me radhë. Kanë numra ERN më vete edhe pse është e
24 njëjta fotografi. Mendoj kjo është arsyeja.

25 Do t'i shikojmë edhe një herë. Për ne ishte e logjikshme

1 që deklarata të lexohej së bashku me lidhjet përkatëse që janë
2 bashkëlidhur. Kjo ka qenë ideja. Dhe fillimisht kështu e kemi
3 bërë.

4 Kemi mbajtur parasysh ato që janë përmendur dhe i kemi
5 ridorëzuar, por desha edhe një herë t'ua shpjegoja "përse"
6 dalim me të njëjta numra ERN-je ndonjë herë edhe pse është i
7 njëjti dokument. Kaq desha të them.

8 Do ta konfirmojmë edhe një herë me NJAGJ-në, por nuk duam
9 që të kemi shmangie nga vula që është vendosur në dokument që
10 mund të jetë përdorur për ndonjë material tjetër që vjen më
11 pas.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
13 do të thosha se për këtë pikë komunikoni me Njësinë e
14 Administrimit Gjyqësor, sepse është shumë teknike dhe nuk dua
15 t'ju them diçka të cilën do të na duhet, përndryshe, ta
16 ndryshojmë. Por numri në *Legal Workflow* duhet të përputhet me
17 dokumentin se përndryshe nuk e gjejmë dot dokumentin. Ky është
18 problemi.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Unë këtë desha të
20 them vetëm. Desha ta sqaroja edhe një herë. Do të jetë në një
21 version të ri, të korigjuar. Punë e vështirë, por do ta
22 bëjmë. Punë për murgj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
24 kuptoj që është punë për murgj, por duhet bërë se e bëjnë të
25 gjithë. Është një punë që e bëjnë të gjithë.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po në rregull.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
3 pra. Atëherë kemi ardhur kështu në fund të konferencës për
4 sot.

5 Seanca do të ndërpritet këtu deri nesër në orën 14.30 kur
6 Trupi Gjykses do të lëshojë një sërë urdhrash gojarisht.

7 Falënderoj palët dhe Mbrojtësja e Viktimave për
8 pjesëmarrjen. Falënderoj përkthyesit, stenografin, teknikët
9 audio-vizivë, personelin e sigurisë dhe në fund, për nga radha
10 por jo për nga rëndësia, Zyrën Administrative për ndihmën e
11 dhënë dhe për pjesëmarrjen.

12 --- Seanca mbyllet në orën 11.52

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25